



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
INSPEKTORATI QENDROR

Nr. 34 Prot.

Tiranë, më 16.01.2023

URDHËR
Nr. 6, datë 16/01/2023

PËR

**KRYERJEN DHE BASHKËRENDIMIN E INSPEKTIMEVE PËR
MBROJTJEN E SHËNDETIT NGA PRODUKTET E DUHANIT**

Në zbatim të shkronjës a, të nenit 16, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Kreut IV, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 696, datë 16.8.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”, si dhe ligjit nr. 9636, datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar, me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik nga përdorimi i produkteve të duhanit dhe ekspozimi i pavullnetshëm ndaj tymit, me fokus të veçantë në monitorimin e zbatimit të nenit 15 të ligjit nr. 9636/2006, mbi ambientet në të cilat ndalohej pirja e duhanit;

URDHËROJ:

1. Kryerjen dhe bashkërendimin e inspektimeve për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit dhe ekspozimi i pavullnetshëm ndaj tymit, nga:
 - 1.1. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH);
 - 1.2. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH);
 - 1.3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU);
 - 1.4. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP);
 - 1.5. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC).
2. Inspektimet të kryhen me dokumente standarde, online, në sistemin elektronik “e-Inspektimi” dhe sipas listë-verifikimit për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, të implementuar në sistem.
3. Inspektorati Qendror (IQ) do të koordinojë veprimtaritë inspektuese të trupave inspektuese, sipas përcaktimeve në Kreun IV, të VKM nr. 696/2013.
4. Ngarkohen ISHSH, ISHPSHSH, AKU, DPAP, AKMC dhe IQ për zbatimin e këtij Urdhri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM
SHKELQIM HAJDARI**